




# DOUGHNUT ECONOMICS

DORACAK



MASTERPEACE  
Creating peace.  
Together.





## Funded by the European Union

**Financuar nga Bashkimi evropian (BE). Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm të autorit/es(ve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit evropian apo Agjencisë Ekzekutive evropiane të Edukitit dhe Kulturës. As Bashkimi evropian dhe as autoriteti i grantit nuk janë përgjegjës për to.**

**Titulli:**  
Doracaku “DOUGHNUT ECONOMICS”

**Projekti:**  
“DO U ACTism”, financuar nga Bashkimi evropian.

**Partnerët e projektit janë:**  
**STICHTING MASTERPEACE, Holandë**  
Ludbreška udruga mladish entuzijasta (LUMEN), Kroaci  
Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime (SIT), Kosovë  
MasterPeace Morocco (MPM), Marok  
Lebanese Development Network (LDN), Liban

**Publikues:**  
**STICHTING MASTERPEACE, Holandë**

**EDITOR:**  
Natalia van der Wee

**Autorë/e:**  
Aart Bos  
Kadri Gashi  
Karin Rozema  
Natalia van der Wee  
Njomza Berisha  
Adnan Retkoceri

**Dizajni Grafik:**  
LDN

2023

<b>Titulli:</b>	<b>3</b>
<b>Mjetet</b>	<b>13</b>
<b>Kohëzgjatja</b>	<b>14</b>
<b>Dizajni i Detajuar i Sesionit</b>	<b>14</b>
<b>Planifikimi</b>	<b>17</b>
<b>Kohëzgjatja</b>	<b>17</b>
<b>Dizajni i detajuar i sesionit</b>	<b>17</b>
Pjesa 1 - Hyrja në Donut	17
Pjesa 2 - Zbërthimi i “the Doughnut”	18
Pjesa 3 - Punë në grupe në kategori	20
<b>Kohëzgjatja</b>	<b>22</b>
<b>Dizajni i Detajuar i Sesionit. Pjesa 1 - Ëndrra e qytetit të lulëzuar.</b>	<b>22</b>
<b>Shtojca I: Manuali i trajnerëve/eve</b>	<b>26</b>
<b>Shtojca II: Fletore pune për pjesëmarrësit/et</b>	<b>26</b>

# Projekti “DOUACTISM”

**DO U ACTism** është projekt i financuar nga Bashkimi Evropian. Ky projekt është bashkë-krijim i pesë organizatave jo-qeveritare (OJQ) të pavarura prej pesë shteteve: STICHTING MASTERPEACE (Holandë), MasterPeace Morocco (Marok), LUMEN (Kroaci), SIT (Kosovë) and LDN (Liban). Misioni ynë i përbashkët është të mobilizojmë talentet për një të ardhme më stabile dhe të kontribuojmë në arritjen e Objektivit të katërt të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG 4) - ArsimCilësor - dhe SDG 16 - Paqe, drejtësi, dhe institucionale të forta. Këto organizata ofrojnë ekspertizë në edukimin joformal dhe punën me të rinjtë/rejat, duke përfshirë punën me minoritetet dhe të rinjtë/rejat e paprivilegjuar/a. Partnerët kanë përvojë në ndërtimin e paqes, fuqizimin e rinasë, dhe angazhimin virtual.

Ne besojmë në ndërtimin e një shoqërie kohezive që është diverse dhe gjithëpërfshirëse dhe po ashtu përbëhet nga qytetarë/e që janë aktivë/e në jetën sociale, ekonomike, kulturore, dhe politike. Metodologjia jonë e Teorisë së Ndryshimit rregullon qasjen tonë në përputhje me Strategjinë e BE-së për Rininë, për t'i angazhuar, bashkuar dhe fuqizuar grupet tona të synuara, si vijon:

- **Angazhim:** Mobilizon, frymëzon dhe bashkon talentet e reja lokale përmes fuqisë transformuese të muzikës, artit, dhe lojës.
- **Bashkon:** Organizon dialog dhe bashkon të gjithë akterët lokalë, duke nxitur bashkëpunimin.
- **Fuqizon:** Krijon perspektiva përmes trajnimeve të liderëve, programeve të ngritisës së kapaciteteve, dhe krijimit të ndërmarrjeve sociale, duke u mundësuar individëve të rinj të bëhen krijues aktivë të ndryshimeve.

Projektet tona të mëparshme dhe analizat e nevojave kanë nxjerrë në pah një hendek të konsiderueshëm besimi midis segmenteve të ndryshme të shoqërisë, veçanërisht midis "të pasurve dhe atyre që nuk kanë", autoriteteve, dhe shoqërisë civile. Shumë të rinj/reja ndihen të marginalizuar dhe besojnë se zërat e tyre nuk kanë rëndësi. Ne synojmë t'i angazhojmë ata/o që shpesh mbeten pas, veçanërisht gratë e reja në zonat rurale, posaçaërisht në vende si Maroku, Kosova dhe Libani.

Duke prezantuar konceptin e "**DO U**", që rrjedh nga libri i Kate Raworth "The Doughnut Economy", ne theksojmë rëndësinë e kohezionit social brenda kufijve planetarë. Partneri ynë, DEAL (Doughnut Economics Action Lab), ofron ekspertizë të paçmuar në këtë fushë. "**ACT-ism**" përfaqëson pjesën e orientuar drejt veprimit të projektit tonë, duke theksuar urgjencën për të adresuar kohezionin social dhe sfidat e mjedisit. Ne gjithashtu i referohemi si "Artistët/et krijojnë së bashku", duke nënkopertuar përdorimin e krijimtarisë, artit, dhe kulturës për të angazhuar dhe bashkuar mes vete individët e komunitetit. ACT simbolizon përgjegjësinë tonë kolektive si arkitektë/e të së ardhmes sonë.

# Rreth këtij doracaku

Ky manual është zhvilluar për t'i angazhuar, bashkuar dhe për t'i fuqizuar të rinxjtë/rejat duke përdorur Teorinë e "Doughnut Economics" si një burim inovativ për trajnerët/et dhe punëtorët/et rinor/e.

Analiza e nevojave tregon se të gjithë partnerët dhe rrjetet tona kanë nevojë për materiale inovative të edukimit joformal (NFE) për të rritur kapacitetin dhe aftësinë e tyre për t'u angazhuar dhe bashkuar me të rinxjtë/rejat. Shpërlarja e trurit dhe shkëputja mendore e të rinxje/rejave është një sfidë e madhe. Mungesa e perspektivës është e lidhur fuqishëm me perspektivat e punës. Ne synojmë të ofrojmë materiale inovative dhe gati për t'u përdorur, për të rritur ndikimin tonë si një drejtues i transformimit dhe më e rëndësishmja, për të mbështetur dhe inkurajuar të rinxjtë/rejat që të marrin përgjegjësinë për të ardhmen e tyre.

Urgjenca për të vepruar është e lartë dhe na mungojnë ekspertizat dhe metodologjitet teorike dhe praktike të arritshme, si dhe mjetet inovative për të punuar mesfidat shumëdimensionale në shoqëri. Epoka digitale kërkon një transformim në të gjitha nivelet. Punëtorët/et rinor/e deklarojnë nevojën për mbështetje në organizimin e formave të mësimit digital të përzier në një nivel teorik-didaktik dhe në nivel praktik.

Manuali mund të përdoret si një burim inovativ informacioni për të drejtuar një program të tillë (NFE) me një objektiv specifik për të adresuar përfshirjen sociale dhe sfidat mjedisore duke mësuar bazat e teorisë së "Doughnut Economics" në bazë të vlerave të përbashkëta të BE-së.

Programi (NFE) është krijuar duke përdorur një qasje mikse të të mësuarit. Përvoja e mësimit të kombinuar në mënyrë të shkëlqyer ndërtohet mbi bazën e mësimit ekspert individual. Ky ndërveprim mund të ndodhë në formatet e mëposhtme: offline - në klasë, dhe virtualisht - përmes mjeteve në internet. Edukimi mund të zhvillohet në rrethana të ndryshme: edukimi formal, edukimi joformal, ose përmes të mësuarit joformal. Inovacioni i kësaj qasjeje qëndron në një kombinim jo vetëm të mësimit online kundrejt atij tradicional, por edhe në hartimin e përvjave të reja dhe krijimin e një kursi që kombinon më të mirat nga të gjitha teknikat mësuese.

Qasja jonë e të mësuarit të përzier në këtë program (NFE) identifikon 3 lloje të të mësuarit;

- 1) ***Udhëhiqet nga mësimdhënësi/ja*** - ndërveprim me një mësimdhënës/e. Punëtori/ja rinor/e/, trajneri/ja, mësimdhënësi/ja nuk është vetëm një burim i njojurive, por edhe një burim frymëzimi, një mentor/e, një dorë ndihmëse;
- 2) ***Puna grupore*** - ndërveprim me bashkëmoshatarët/et. Aftësia për të punuar në grup dhe për të arritur rezultate (qasje e bazuar në projekte);
- 3) ***Vetë-studim*** - të rinjtë/rejat marrin përgjegjësi. Aftësia për të punuar individualisht, për t'u përqëndruar në objektivin dhe për të arritur rezultate personale.

Kursi i trajnimit është i bazuar në principet dhe metodat e edukimit jo-formal. Ky kurs trajnimi përmban metoda interaktive për të njojur nevojat e të mësuarit të pjesëmarrsve/eve, duke përfshirë: inputet teorike, aktivitetet grupore dhe individuale, sfidat grupore, prezantime, lojën me role, rastet e studimit, diskutimet dhe metoda të tjera.

Doracaku dhe të gjitha materialet tjera janë të përgatitura në gjuhën angleze dhe janë të përkthyera në gjuhët amëtare të të gjithë partnerëve: shqip, arabisht, serbo-kroatisht dhe holandisht. Videot nga platforma e Youtube janë modifikuar varësisht nga konteksti dhe gjuha lokale përmes titrimit. Disa janë zëvendësuar me video të tjera.

Audienca e synuar e këtij manuali janë punëtorët/et rinorë/e, trajnerët/et dhe udhëheqësit/et e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) dhe përfituesit/et përfundimtarë/e të edukimit - të rinjtë/rejat e moshës 16+.

# Hyrje

Këto materiale NFE mbi teorinë e “Doughnut Economics” u ofrojnë të rindje/rejave një kornizë inovative dhe një perspektivë të re për zhvillim të qëndrueshëm. Në këtë program të të mësuarit joformal, pjesëmarrësit/et ftohen në një udhëtim transformues për të eksploruar konceptet kryesore të Doughnut Economics dhe implikimet e tyre për të ardhmen e komuniteteve të tyre. Nëpërmjet aktiviteteve interaktive dhe diskutimeve që nxisin mendimin, të rindjtë/rejat eksplorojnë qasjen holistike të Doughnut Economics dhe zbulojnë se si përputhet me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs). Ata/o do të zbatojnë Metodologjinë e Portretit të Qytetit për të vlerësuar performancën sociale dhe mjesidore të qytetit ku jetojnë.

## Sesioni 1: Vlerat

Në këtë sesion, pjesëmarrësit/et do të zbulojnë konceptin e vlerave thelbësore dhe do të mësojnë se si këto vlera reflektohen në sjelljet tona. Nëpërmjet diskutimeve interaktive, ushtrimeve të vetë-reflektimit dhe aktiviteteve atraktive, pjesëmarrësit/et do të kuptojnë thollë se si vlerat e tyre individuale përputhen me vlerat më të gjera të mbështetura nga Organizatat e Kombeve të Bashkuara (OKB). Kuptimi i vlerave të OKB-së është i një rëndësie të madhe në botën e sotme. Kombet e Bashkuara mishërojnë një sërë parimesh që promovojnë demokracinë, të drejtat e njeriut, respektimin e diversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Duke i kuptuar dhe përbrendësuarkëto vlera, shtetet mund të mbrojnë dhe fuqizojnë të drejtat e qytetarëve të tyre dhe të sigurojnë kohezionin social. Për më tepër, respektimi i vlerave të OKB-së kontribuon në paqen dhe stabilitetin global, pasi inkurajon bashkëpunimin diplomatik, zgjidhjen e konflikteve dhe përpjekjet për ndërtimin e paqes. Përbrendësimi i këtyre parimeve nuk është vetëm i dobishëm për vendet individuale, por edhe për komunitetin ndërkombëtar në tërësi, pasi ai shtron themëlet për një botë më të drejtë, më të barabartë, dhe më të begatë.

Në fund të këtij sesioni, pjesëmarrësit/et do të kenë fituar një kuptim më të thollë të vlerave thelbësore, vlerave të tyre personale dhe lidhjes së tyre me vlerat e OKB-së. Ata/o do të pajisen me njohuritë dhe mjetet e reflektimit për të harmonizuar veprimet dhe vendimet e tyre me vlerat e tyre në mënyrë që të kontribuojnë në një të ardhme të qëndrueshme të bazuar në vlerat e përbashkëta të OKB-së.

## **Sesioni 2: Modeli i Doughnut për Botën**

Në këtë sesion, pjesëmarrësit/et hyjnë në zemrën e Doughnut Economics - vetë modeli i donat. Nëpërmjet ushtrimeve interaktive, ata/o do të eksplorojnë rëndësinë e kufijve të jashtëm ekologjikë dhe themelin e tyre të brendshëm shoqëror. Ata do të mësojnë se si ky përfaqësim vizual i zhvillimit të qëndrueshëm na shërben si një busullë për të lundruar në kompleksitetin e botës sonë. Nëpërmjet aktiviteteve dinamike në grup, ata/o do të shqyrtojnë matjet e Donat mbi mirëqenien të gruvara në pesë kategori: të fuqizuar, të lidhur, të aktivizuar, të shëndetshëm dhe ekologjik dhe do të diskutojnë se si ato përputhen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) dhe kërkimin shkencor mbi shëndetin e planetit.

## **Sesioni 3: Portreti i qytetit**

Në këtë sesion praktik, pjesëmarrësit/et do të krijojnë një portret të qytetit ose rajonit ku jetojnë duke mbledhur dhe analizuar të dhëna për tregues të ndryshëm për pesë kategoritë e Donat-it. Duke hartuar performancën e qytetit të tyre mbi këta tregues, ata/o do të mbledhin një pamje të qartë se ku ndodhet qyteti për sa i përket arritjes së qëndrueshmërisë sociale dhe mjedisore.

Ata/o do ta përdorin këtë mjet të fuqishëm për të identifikuar fushat e përmirësimit dhe për të zhvilluar një plan veprimi për të ndihmuar qytetin e tyre të ecë drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme dhe të barabartë.

Fuqia e ndryshimit qëndron brenda komuniteteve dhe veprimit kolektiv. Si rezultat i këtij programi (NFE), pjesëmarrësit/et do të fitojnë njoħuri të vlefshme për potencialin për transformimin e sistemeve ekologjike dhe sociale në komunitetin e tyre. Të pajisur me njoħuri, frymëzim dhe një kuptim të thellë të lidhjeve midis Doughnut Economics dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), ata/o do të jenë të pajisur mirë për t'u bërë katalizatorë për ndryshim.

## **Qëllimet kryesore të programit janë:**

- Krijimi i projekteve komunitare të fokusuara në adresimin e përfshirjes sociale dhe sfidave mjedisore në nivel lokal;
- Një dialog i strukturuar me përfaqësuesit/et e qyteteve dhe këshillimi i tyre se “si të krijohet një qytet që lulëzon”;

- Inkurajimi i pjesëmarrjes politike dhe bashkëpunimit ndërmjet të gjithë akterëve lokalë: qeverive, bizneseve, dhe qytetarëve/eve të rinj/reja për të zhvilluar strategji praktike për të nxitur ndryshime pozitive.

## Programi i Edukimit Jo-Formal (NFE)

Ky program përbëhet nga dizajne të detajuara të sesioneve të bazuara në parimet e të mësuarit të kombinuar. Materialet përfshijnë shtojca me udhëzime shtesë për trajnerët/et dhe fletëpalosje për pjesëmarrësit/et. Të gjitha seancat ofrojnë lidhje me prezantime të gatshme për përdorim (Canva) për të mbështetur nevojën për burime dixhitale, vizuale, dhe multimediale.

Në të njëjtën kohë, programi lë shumë liri për të bërë ndryshime dhe rregullime për të përmbushur nevojat specifike të trajnerëve/eve dhe pjesëmarrësve/eve dhe mund të përshtatet ose përdoret në shumë formate.

### Përshkrimi:

#### Vlerat:

Ky është sesioni i parë i programit të edukimit jo-formal “DoUAct”.

Në këtë sesion të dytë, ne përcaktuam qëllimet (vlerat). Përmes këtij sesioni ndërgjegjësohen pjesëmarrësit/et për rëndësinë dhe ndikimin e vlerave. Poashtu, i diskutuam vlerat në nivel kombëtar dhe të OKB-së.

#### Doughnut Economics:

Pjesëmarrësit/et mësojnë se gjithçka është e ndërlidhur dhe se si veprimet lokale mund të kenë një efekt global. Ata/o mësojnë se si “Doughnut Economics” përcakton një hapësirë të sigurt dhe të drejtë për njerëzimin. Ata/o zgjedhin (ose u caktohen) një nga pesë temat e donat dhe punojnë brenda tyre.

#### Portrete të qytetit:

Të rinjtë/rejat mësojnë mbi parimet e hulumtimitdhe konceptin e Portretit të qytetit dhe rolin e tyre në ndërtimin e komuniteteve të qëndrueshme dhe paqësore. Ata/o do të organizojnë një intervistë me banorët/et vendas/e në mënyrë që të identifikojnë

problemet thelbësore dhe të përdorin këtë evidencë për zhvillimin e ardhshëm të projektit. Në këtë sesion mblidhen të gjitha njohuritë dhe përgatitjet e mëparshme për të kriuar Portretin e Qytetit.

## **Qëllimet mësimore**

### **Vlerat:**

- 1.1 Njohuri: ju shpjegoni se çfarë janë vlerat.
- 1.2 Reflektim: e kuptoni pse vlerat janë të rëndësishme dhe si ndikojnë atonë sjellje.
- 1.3 Reflektim: jeni të vetëdijshëm se vlerat ndryshojnë nga personi në person dhe nga grupi në grup.
- 1.4 Aftësia: ju tregoni se cilat vlera janë më të rëndësishme për ju dhe mund të shpjegoni pse ato janë më të rëndësishme për ju.
- 1.5 Qëndrimi: ju tregoni sjellje të motivuar nga vlera.

### **Doughnut Economics:**

- 2.1 Njohuri: ju mund të shpjegoni “Doughnut Economics” dhe pesë temat e tij në një kuptim të gjerë.
- 2.2 Reflektim: ju mund të lidhni qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm me “Doughnut Economics”.
- 2.3 Reflektim: ju mund të deklaroni se cilat sfida globale dhe/ose lokale janë të rëndësishme për ju dhe pse.
- 2.4 Aftësia: Ju keni zgjedhur, si ekip, një nga pesë temat e donat-it për të cilat dëshironi të mësoni më shumë dhe për të cilat dëshironi të bëni një ndryshim pozitiv. Bazuar në priorititet, talentet dhe interesat e ekipit.

## ***Portreti i qytetit:***

3.1 Njohuri: ju dini si të bëni një analizë të situatës aktuale lokale duke u fokusuar në një nga pesë temat e donat, duke përfshirë këndvështrime të ndryshme.

3.2 Reflektim: ju mund të analizoni se cilët faktorë kanë më shumë ndikim për të përmirësuar situatën aktuale lokale për një nga pesë temat e donat për qytetin tuaj. Duke marrë parasysh aspektet e ndryshme të sistemit (lokal kundrejt global, individual kundrejt kolektiv, etj.)

3.3 Aftësia: ju mund të formuloni këshilla për vendimmarrësit/et për atë që duhet të ndryshojë për të përmirësuar situatën aktuale duke marrë parasysh aspektet e ndryshme të sistemit.

## **Mjetet**

- Loja e vlerave thelbësore;
- Hyrja në Donat;
- Zbërthimi i Donat;
- Punë në grup dhe prezantim;
- Eksplorimi i temës;
- Tabelat “Miro”.

## **Koha e nevojitur:**

Kjo seancë është planifikuar të mbahet brenda 8 orëve. Audienca e synuar vendosë nëse është e nevojshme ta mbajmë atë brenda një dite, apo do t'i ndajmë materialet në trajnime dy-ditore (4 orë në ditë).

# Vlerat

*Dizajni i detajuar i sesionit*

**PROGRAMI (NFE) :** DO U ACTivism

**AUDIENCA E SYNUAR:** mosha 19-30 vjeç

## Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e sesionit është 90 minuta.

Materialet:

- [Prezentimi 4](#)
- [Manuali i trajnerëve Doughnut](#)
- [Fletore pune Doughnut](#)

## Dizajni i Detajuar i Sesionit

Koha	Udhëzime	Materiale
5 min.	<p><b>Hyrje</b></p> <p><b>Interesi</b> - tregoni videon në YouTube për ndryshimin midis vlerave dhe qëllimeve.</p> <p><b>Nevoja</b> - referojuni sesionit të prezantimit ku ne punuam me vlerat "kujdesuni mirë për veten, të tjerët, dhe mjedisin tuaj". Shpjegoni se në këtë sesion do të thellohemë në vlerat thelbësore personale. Ato vlera që ju i konsideroni më të rëndësishmet në jetën tuaj dhe kështu formojnë një busull për të gjitha sjelljet dhe vendimet tuaja që merrni.</p> <p><b>Koha</b> - informoni pjesëmarrësit se seanca zgjat 1.5 orë dhe diskutoni temat.</p> <p><b>Përgjigje</b> - do të hulumtonisë bashku në mënyrë aktive se cilat janë vlerat tuaja thelbësore dhe ato të të tjerëve. Dëgjoni me kujdes, bëni pyetje dhe jepini hapësirë njëri-tjetrit.</p>	<p><a href="#"><u>Prezentimi - 4</u></a></p> <p><a href="#"><u>Values vs Goals - By Dr. Russ Harris</u></a></p>

Koha	Udhëzime	Materiale
	<p><b>Objektivat</b> - Informoni pjesëmarrësit për qëllimet mësimore të këtij sesioni specifik.</p>	
15 min.	<p><b>Ndryshimi mes vlerave dhe normave</b></p> <p><b>Qëllimi:</b> të shpjegojë dhe të përkufizojë më tej konceptin e vlerave &gt; qëllimi mësimor 2.1 &amp; 2.2</p> <p>Filloni me rastin. Lërini pjesëmarrësit/et të mendojnë individualisht fillimisht dhe të shkruajnë përgjigjen e tyre në fletoren e punës. Më pas diskutoni rezultatet me grupin dhe dalloni normat dhe vlerat.</p> <p>Diskutoni përkufizimet e normave dhe vlerave dhe jepni shembuj. Mbaro me kuizin. Jepini secilit pjesëmarrës/e një copë letër rozë dhe blu. Kërkojuni të mbajnë lart copën e letrës me ngjyrën që ata/o mendojnë se është përgjigjja e saktë.</p> <p><b>Stili i të mësuarit - teorikisht</b> Shembuj që ju sfidojnë të kuptoni më mirë situatën, kohën, dhe hapësirën për të menduar.</p>	<a href="#">Prezentimi 4</a> <a href="#">Fletore pune për pjesëmarrës/e</a> Copëza letre rozë dhe të kaltra
45 min.	<p><b>Loja e vlerave thelbësore</b></p> <p><i>(!) Shënim: mund të përdorni variante të tjera të lojërave me vlerë që ju i dini.</i></p> <p><b>Qëllimi:</b> pjesëmarrësit/et të njohin veten dhe njëri-tjetrin (më mirë) në atë që ata/o e shohin me të vërtetë të rëndësishme në një mënyrë lozonjare. &gt; Qëllimi i të mësuarit 2.4 &amp; 2.5</p> <p>Lexoni manualin e lojës për vlerat bazë. Ndani grupin në ekipe me 4-6 persona. Mund të operoni deri në katër grupe për lojë. Nëse ka më shumë grupe, ju duhet një lojë shtesë. Jepni grupeve udhëzime të printuara. Pasi të përfundojë loja, ndiqni pyetjet në Manualin e Trajnerëve për të udhëhequr bisedën rreth vlerave.</p>	Manuali i lojës së vlerave bazë ( <a href="#">shih manualin e trajnerëve/eve</a> )  Letra A4, stilolapsa  <a href="#">Fletore pune për pjesëmarrës/e</a>

Koha	Udhëzime	Materiale
20 min.	<p><b>Vlerat në nivel kombëtar dhe OKB</b></p> <p>Qëllimi: krijimi i vetëdijes për vlerat në nivel kombëtar dhe të OKB-së dhe se si kjo ndikon në vlerat personale. &gt; qëllimi mësimor 2.3</p> <p>Ndajeni grupin në dyshe dhe kërkojuni të gjejnë vlerat e duhura thelbësore në Kosovë/vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB) për çift.</p> <p>Më pas kërkojini grupit të japë shembuj për vlerën e normave/sjelljeve që u përkasin vlerave dhe që shohin në mjedisin e tyre, dhe shembuj të normave/sjelljeve që nuk janë në përputhje me vlerat. Shkruani shembujt në një copë letre të madhe. Vareni këtë në sallë.</p> <p>Mbylli këtë temë duke ofruar një pasqyrë se si vlerat dhe sjellja personale ndikohen nga vlerat dhe sjellja në një nivel kolektiv. Duke përdorur modelin AQAL të Ken Wilber. Shihni shënimet në prezantim për shpjegime të mëtejshme.</p> <p><b>Stili i të nxenit - teorik</b> Ide komplekse që ju sfidojnë të kuptioni më mirë situatën.</p>	<p>Stilolapsa</p> <p><u>Fletore pune për pjesëmarrës/e</u></p> <p>Një copë të madhe letre Markera</p> <p><a href="https://www.youtube.com/watch?v=6ktot_77_i">https://www.youtube.com/watch?v=6ktot_77_i</a></p>
5 min.	<p><b>Mbyllja</b></p> <p>Informoni pjesëmarrësit/et se kur do të takoheni përsëri dhe çfarë është më tutje në agjendë.</p>	

# Doughnut Economics

## Planifikimi

*Dizajni i detajuar i sesionit*

**PROGRAMI (NFE):** DO U ACTism

**AUDIENCA E SYNUAR:** mosha 19-30 vjeç

## Kohëzgjatja

Ky sesion përbën 4 pjesë nga 45 minuta secila. Koha totale e mësimit është 3 orë.

## Dizajni i detajuar i sesionit

- [Prezentimi 5](#)
- [Manuali i trajnerëve Doughnut](#)
- [Fletore pune Doughnut](#)
- [Kuizi](#)

### Pjesa 1 - Hyrja në Donut

Koha	Udhëzime	Materiale
5 min	<p><b>Hyrje</b></p> <p>Mirëpritni pjesëmarrësit/et dhe shpjegoni se sot do të mësojmë për “Doughnut Economics”.</p> <p>Interesimi - Frika e Donatit/Fear of Doughnuts?</p> <ul style="list-style-type: none"><li>• “Pra kush ka frikë nga Donat? - askush huh...”</li><li>• “Dhe kujt i duket pak frikësuese ekonomia?”</li><li>• “Ne e dimë se fjala 'ekonomi' mund të jetë frikësuese, por shumë pak njerëz kanë frikë nga Donat ... dhe ju premtoj pas sesionit të sotëm që do t'ju pëlqejnë të dyja!“ - kjo është një mënyrë më tërheqëse për të eksploruar ekonominë dhe</li></ul>	<a href="#"><u>Prezentimi 5</u></a>

	<p>një qëllim të ri për atë që mund të jetë ekonomia.</p> <p><b>Nevoja - Citim:</b> Kujtojuni pjesëmarrësve/eve atë që kemi mësuar rreth sfidave globale dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs), ka shumë për të bërë dhe ne kemi nevojë për një sistem të mirë për t'i trajtuar këto. Ky është një sistem mjaft i dobishëm!</p> <p><b>Koha - Gjithsej</b> do të kalojmë 3 mësime për Doughnut Economics.</p> <p><b>Përgjigje - Dëgjim aktiv, pjesëmarrje aktive, reflektim kur kërkohet.</b></p> <p><b>Objektivat - Për të fituar një kuptim themelor të asaj çfarë është Doughnut Economics dhe lidhjen e saj me të menduarit sistematik.</b></p>	
40 min	<p><b>Hyni në “Donat”</b></p> <p>Rrethi i jashtëm: Kufijtë planetarë (10 min)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Çfarë përfaqëson kufiri planetar?</li> <li>• Cilët janë 9 kufijtë planetarë?</li> </ul> <p>Rrethi i brendshëm: Themelimi Shoqëror (10 min)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Çfarë përfaqëson kufiri planetar?</li> <li>• Cilët janë 12 faktorët e themelimit shoqëror?</li> </ul> <p>Ushtrim ndërgjegjësimi (5 min)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit/et apo studentët/et do të ecin përreth hapësirës duke 'ndjerë' në zona të ndryshme.</li> <li>• Kjo do të krijojë një kuptim emocional të fushave të ndryshme të “donatit.</li> </ul> <p>Reflektim në çifte(10 min)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Me ndihmën e 3 udhëzimeve, pjesëmarrësit/et do të ndajnë përvojën e tyre me një partner/e.</li> </ul> <p>Reflektim i grupit të vogël dhe mbyllje (5 min)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pyetje reflektuese.</li> <li>• Pikat kryesore të ushtrimit.</li> </ul>	<p><a href="#">Prezentimi 5</a></p> <p><a href="#">Manuali i trajnerëve:</a> Ushtrimi: Hyrja në Donat</p> <p>Materialet e nevojshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dy litarë</li> <li>• Postera me faktorë</li> </ul> <p><a href="#">Gjeni mjetin origjinal në platformën DEAL(doughnut economics action lab)</a></p> <p><a href="#">Këshillë! Shikojeni klipin në youtube në përgatitje, ndihmon shumë për të kuptuar dhe parë se si funksionon në praktikë</a></p>

## Pjesa 2 - Zbërthimi i “the Doughnut”

Koha	Udhëzime	Materiale
5 min	<p><b>Hyrje</b></p> <p><b>Objektivat:</b> Qëllimi i "Donat" është të plotësojë nevojat e të gjithë njerëzve brenda planetit, por çfarë do të thotë kjo përlagjet, qytetet, rajonet apo vendet ku jetojmë?</p> <p>Për të eksploruar këtë pyetje, ne tani do të 'zbërthejmë' "Donat-in" dhe do të zbulojmë katër 'perspektiva' që ju ftojnë të shikoni ndërveprimin midis aspiratave lokale dhe përgjegjësive globale në vendin tuaj – si në aspektin social ashtu edhe në atë ekologjik – dhe të identifikoni pikat e mundshme hyrëse përvetësuese transformues.</p> <p>Ndërsa po kalojmë në sesion, vazhdoni të pyesni veten se cilat temat nxisin emocione? Çfarë ju intereson? Ku mund ta shihni veten duke ndikuar?</p>	
30 min	<p><b>Zbërthimi i "donat-it" - 4 perspektivat</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><b>1: Perspektiva lokale-sociale (5 min)</b></li> <li><b>2: Perspektiva lokale-ekologjike (5 min)</b></li> </ul> <p><b>Video (max 5 min)</b></p> <p>Gjeni një video 2-5 minutëshe të një projekti të nismës lokale, i cili kontribuon në perspektivat sociale, ekologjike ose të dyja, përfshirë t'u dhënë studentëve/eve një shembull të jetës reale, të cilin ata madje mund ta njohin. Nëse nuk mund ta gjeni një të tillë, mund të shfaqni një nga filmat e "Freedom Fighters" me titra në anglisht.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li><b>3: Perspektiva Globale-Ekologjike (5 min)</b></li> <li><b>4: Perspektiva Globale-Sociale (5 min)</b></li> </ul> <p><b>Kuizi Kahoot (5 min)</b> 10 pyetje - në cilën perspektivë bën pjesë secila foto?</p>	<p><a href="#">Prezantimi 5</a></p> <p><b>Manuali i trajnerëve:</b> Ushtimi përfshirë <u>Donat-in - Ruani</u> <u>rezultatet e ushtimit. Ato</u> <u>do të përdoren në</u> <u>sesionin 10. Portreti i</u> <u>qytetit</u></p> <p>Video e një iniciative/projekti lokal <a href="https://www.youtube.com/watch?v=GoVXiFts8sQ">https://www.youtube.com/watch?v=GoVXiFts8sQ</a></p> <p><a href="#">Kuizi</a></p> <p>Mjet origjinal dhe i plotë në platformën DEAL (në përdorim një version të modifikuar).</p>
5 min	<p><b>Ndërlidhja globale-lokale</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shembuj të ndërlidhjeve ndërmjet katër perspektivave</li> <li>Lidhja me sistemin e të menduarit</li> <li>Hapësirë përvetësuese për pjesëmarrësit/et që të ndajnë shembuj.</li> </ul>	<a href="#">Prezantimi 5</a>

<p>5 min</p> <p><b>Identifikimi i mundësive</b></p> <p>“Donat” na stimulon të mendojmë dhe të veprojmë ndryshe - të ëndërrrojmë më shumë seç kemi ëndërruar ndonjëherë më parë - dhe të gjemjë mënyra për vendet tona që të gjithë të kontribuojnë për të sjellë njerëzimin brenda “Donat-it”. Për ta bërë këtë, ne duhet të zhvillojmë imagjinatën tonë kolektive për të filluar t'i pranojmëtë gjitha mundësitë e pabesueshme që ne mund t'i krijojmë.</p> <p><b>Video</b></p> <p>Përfundoni sesionin me një ton shpresëdhënës duke e luajtur videon “A day in 2030”.</p>	<p>Prezantim</p> <p>Video: <a href="#">A day in 2030</a></p>
---	--

### Pjesa 3 - Punë në grupe në kategoritë

Koha	Instruksione	Materiale
5-10 min	<p><b>Hyrje në 5 kategoritë (5 min)</b></p> <p><b>Objektiva:</b> Meqenëse rezultati përfundimtar i këtij projekti është një projekt i komunitetit lokal, sot do të fillojmë të eksplorojmë perspektivat lokale të “Donat-it” dhe të eksplorojmë në thellësi një temë të zgjedhur prej tyre.</p> <p>Për qëllimin e këtij projekti, ne do t'i ndajmë faktorët e “Donat-it” në 5 kategori: <b>të fuqizuar, të bashkuar, të aktivizuar, të shëndetshëm dhe ekologjikë/e</b>. Çdo kategori përbëhet nga një sërë faktorësh të “Donat-it”, kaloni nëpër to ndërsa ju tregoni sllajdin. Kërkoni nga pjesëmarrësit/et të japid një shembull për secilën temë. Shkruajini këto në letrat që ngjiten dhe ngjitet pranë çdo temë në tabelë, ose shkruajini në tabelë.</p> <p>Video (max 5 min) Këtu është mirë të tregosh një video-mesazh të një politikani/e/figure publike/artisti/eje/aktivisti/eje/ apo dikush tjetër si burim frymëzimi dhe motivimi, dhe t'i lidhësh ato me çështjet lokale.</p>	<p><a href="#">Prezantimi 5</a></p> <p>Opsionale për shembuj të secilës kategori: letra që ngjiten</p> <p>Video mesazh i ndonjë akteri lokal</p>
20-25 min	<p><b>Ndarja në grupe (max 5 min)</b></p> <p>Luaj me pjesëmarrësit kuizin gjej tematikën e donat-it tënd. Në bazë të rezultateve të tyre, ata/o do të futen në tema sipas asaj që është në krye të listës së tyre. Nëse një temë ka shumë më</p>	<p><a href="#">Prezantimi 5</a></p> <p><a href="#">Kuiz</a>: gjej tematikën e donatit tënd</p>

	<p>shumë pjesëtarë/e se të tjerat, kërkojuni disave që të rishpérndahen në zgjedhjet e tyre të dyta ose të treta derisa të jenë në grupe relativisht të barabarta.</p> <p><b>Brainstorming</b> (rreth. 10 min)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Lidhja e fjalëve me kategorinë.</li> <li>• Gjetja e frysmit: në pajisjet e tyre pjesëmarrësit/et kërkojnë projekte/iniciativa lokale dhe globale që kanë të bëjnë me zgjedhjen e kategorisë së tyre.</li> </ul> <p><b>Përgatitja e prezantimit</b> (rreth. 10 min)</p> <p>Nëse nuk e kanë bërë tashmë këtë, kërkojuni studentëve të përgatisin prezantimet e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ata/o zgjedhin një prej projekteve/iniciativave</li> <li>• Përgatitni një prezantim 3-minutësh mbi projektin/iniciativën e zgjedhur</li> </ul>	<p><a href="#"><u>Fletore e punës së pjesëmarrësve/eve:</u></a> Doughnut Economics Brainstorming</p> <p>Fletore pune përmesimdhënësit/et: lista e ekipoit</p>
15 min	<p><b>Prezantime të shkurtëra në grup</b></p> <p>Secilit grup i jepet 3 minuta</p> <p>Prezantimi i një projekti/iniciative që ata e shohin frysmit duhet të përfshijë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Emri, vendi dhe koha;</li> <li>• Si lidhet kjo me temën tonë? - lidheni atë me secilin faktor veç e veç;</li> <li>• Përse na duket frysmit kjo?</li> <li>• Si mund ta përshtasim këtë në kontekstin tonë lokal?</li> </ul>	<p><a href="#"><u>Prezentimi 5</u></a></p> <p><a href="#"><u>Fletore e punës së pjesëmarrësve/eve:</u></a> Doughnut Economics Brainstorming</p>

# Portreti i qytetit

*Dizajni i Detajuar i Sesionit*

**NFE PROGRAMI:** DO U ACTism

**AUDIENCA E SYNUAR:** 19 - 30 vjeç

## Kohëzgjatja

Punëtoria përmban 3 module nga 90 minuta secili. Koha totale e studimit është 3 orë. Çdo modul mund të ndahet në dy sesione prej rreth 45 - 50 minutash, në mënyrë që të përshtatet më lehtë në planifikimin e arsimit formal.

## Udhëzimet e përgatitjes

Në këtë fazë të projektit pjesëmarrësit/et ndahan në 5 grupe sipas 5 këndvështrimeve të Doughnut Economics. Në sesionet e mëparshme (8. Literatura mediatike dhe 9. Dialogu) pjesëmarrësit identifikuin një listë të mediave dhe burimeve të tjera me informacione të besueshme për situatën lokale dhe mblorehën mendime të palëve të ndryshme të interesuara që mund të përdoren për qëllimet e këtij sesioni.

- [Prezentimi 6](#)
- [Manuali i trajnerëve Doughnut](#)
- [Fletore pune Doughnut](#)

# Dizajni i Detajuar i Sesionit. Pjesa 1 - Ëndrra e qytetit të lulëzuar.

Koha	Udhëzime	Materiale
5 min	<p><b>HYRJE</b></p> <p><b>Interesimi</b> - Kërkojuni studentëve/eve të mendojnë për shprehjen "Mendoni globalisht - veproni në nivel lokal" ndërsa ata shikojnë dy video në YouTube në të cilat të rinjtë/rejat trajtojnë ndryshimet klimatike në nivel lokal dhe atë global.</p> <p><b>Nevoja</b> - Referojuni sesioneve të mëparshme të fazës "Planifikimi". Tani kemi të gjithë informacionin dhe njohuritë e nevojshme për të analizuar nevojën aktuale për ndryshim dhe për të kuptuar hapat e ardhshëm. Qëllimi i këtij sesioni është krijimi i një "Portreti të qytetit" të komunitetit lokal ku jetojnë nxënësit/et (qyteti, rajoni, komuniteti - varet nga niveli i marrëveshjeve që arrihet me autoritetet komunale).</p> <p><b>Kohëzgjatja</b> - informoni pjesëmarrësit/et që seanca përbëhet nga 3 pjesë nga 45-50 minuta secila dhe më pas diskutoni temat.</p> <p><b>Përgjigje</b> - do të punoni në grupe dhe do të analizoni në mënyrë aktive situatat lokale në kontekstin e 5 këndvështrimeve të Doughnut Economics.</p> <p><b>Objektivat</b> - Informoni pjesëmarrësit/et për qëllimet mësimore të këtij sesioni specifik (më lartë). Meqenëse sesioni është i ndarë në 3 pjesë, qëllimet shpërndahen gjithashtu në tre dimensione:</p> <p>Pjesa 1 - fitoni njohuri për metodologjinë;</p> <p>Pjesa 2 - mbledhni të dhëna për analizë;</p> <p>Pjesa 3 - analizoni të dhënat dhe formuloni përfundimet.</p>	<p><a href="#">Prezentimi 6</a></p> <p><a href="https://www.youtube.com/watch?v=YYzqTCUiMWM">https://www.youtube.com/watch?v=YYzqTCUiMWM</a></p> <p><a href="https://www.unicef.org/stories/young-climate-activists-demand-action-inspire-hope">https://www.unicef.org/stories/young-climate-activists-demand-action-inspire-hope</a> (zgjidhni vetëm një nga videot e listuara në vegëzën e dytë dhe shtojeni në prezantimin tuaj)</p>
10 min	<p>Drejtoni diskutimin dhe shkruani përgjigjet në tabelë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Çfarë duhet ndryshuar në botë? (mbledhni mendime, inkurajoni studentët/et)</li> <li>- Pse janë të nevojshme këto ndryshime? (Shkruani arsyet në një kolonë të veçantë - kjo është baza e motivimit).</li> <li>- Si janë të dukshme nevojat globale në nivel lokal?</li> </ul>	<p>Ju mund t'i shkruani shkurtimisht idetë e përmendura në flip chart ose në letra - ato mund të shërbejnë si frysëzim për detyrat e ardhshme.</p> <p>Përdorni këto pyetje për të formuluar temën tuaj të</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kush duhet të bëjë një ndryshim?</li> <li>- Çfarë mund të bëjmë tani?</li> </ul> <p>Referojuni Rezultateve të ushtrimit "Zbërtheje" Doughnut. Kujtojuni nxënësve qytetin imagjinar të lulëzuar që ata krijuan (shfaqni gjetjet në ekran).</p> <p>Rezultatet e kësaj pjese shërbejnë si bazë për portretin e qytetit.</p>	kërkimit
15 min	Studentët/et krijojnë pyetjet e tyre bazuar në temën e hulumtimitpër të vërtetuar konceptin në seancën e intervistimit. Ata/o gjithashtu krijojnë një listë pyetjesh për t'u përgjigjur gjatë rishikimit të literaturës.	Përdorni një fletushkë me pyetje për të krijuar portretin e qytetit
5 min	<b>Mbyllja:</b> Mësuesi/ja jep udhëzimet përfundimtare për pjesën tjetër të sesionit - punë e pavarur në grup (shih përshkrimin e pjesës 2 më poshtë).	

## Dizajni i Detajuar i Sesionit. Pjesa 2 - Hulumtimi

Koha	Udhëzime	Materiale
5 min	<p><b>HYRJE</b></p> <p>Kjo është një seancë praktike. Në pjesën e dytë të sesionit portreti i qytezit studentët/et do të mbledhin të dhëna për analizën duke punuar në 5 grupet e këndvështrimeve të Donat-it.</p> <p><b>Këshillë:</b> Kjo pjesë e seancës mund të mbahet jashtë orarit të mësimitdhe të përdoret si detyrë shtëpie.</p>	<p><a href="#">Prezentimi 6</a></p> <p>Faza e veprimit mund të regjistrohet për prezantime të ardhshme të rezultateve ose krijimin e një filmi rrith projektit.</p>
5 min	<p>Detyra e secilit prej 5 grupeve është të analizojë situatën aktuale në qytetin e tyre në kontekstin e secilës prej 5 këndvështrimeve të Donat-it.</p> <p>Grupet ndahan në dy pjesë: njëri do të kryejë kërkime në tavolinë, tjetri do të intervistojë palët e tjera të interesuara (qytetarë/e, përfaqësues/e të bashkisë, autoritetet e shkollës etj.)</p>	<p>Ndihmojuni studentëve/eve të organizojnë intervista me përfaqësues/e të publikut nëse kjo është planifikuar. - prandaj krijojmë pyetësorë për hapin tjetër.</p>

40 min	<p>1) Një pjesë e studentëve/eve në secilin nga 5 grupet hulumtojnë dhe shënojnë gjetjet e tyre rreth çështjeve aktuale në qytet.</p> <p>2) Një pjesë tjetër e secilit prej grupeve del në rrugë për të mbajtur intervista të shkurtëra bazuar në pyetësorët e zhvilluar.</p> <p>Additionally (or as an option), students may start a quick quiz on social media.</p>	<p>Përdorni pyetësorët e krijuar në pjesën e mëparshme të sesionit.</p> <p>Printoni fletushkat paraprakisht</p>
	<p>Të gjitha rezultatet mbledhen në hapësirën e dedikuar në internet: Google Drive, Miro board, Dropbox, Padlet ose çdo platformë tjetër që përdor shkolla.</p>	<p>Krijoheni këtë hapësirë paraprakisht dhe njoftoni studentët se ku të ruajnë informacionin.</p>

## Dizajni i Detajuar i Sesionit. Pjesa 3 - Lidhja e pikave.

Koh a	Udhëzime	Materiale
5 min	<p><b>HYRJE</b></p> <p>Referojuni pjesës së mëparshme. Kjo është një vazhdimësi e punës në City Portrait. Në pjesën 3, ne do të mësojmë t'i analizojmë të dhënat dhe të formulojmë përfundime.</p>	<a href="#">Prezentimi 6</a>
20 min	<p>Mësuesi/ja shpjegon detyrën: studentët duhet të punojnë në grupe për të plotësuar kanvasinme faktet që mbloreh dhe vizionin e së ardhmes së lulëzuar në temën e tyre.</p> <p>Mësuesi u kujton studentëve rregullat e bashkëpunimit produktiv:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Punoni si grup dhe gjeni vendime të përbashkëta për faktet që janë të rëndësishme për grupin tuaj dhe projektin e ardhshëm.</li> <li>- Zgjedhni faktet me kujdes.</li> <li>- Lejoni të gjithë të flasin.</li> </ul>	<a href="https://miro.com/app/board/uXjVOXCT4-w/">https://miro.com/app/board/uXjVOXCT4-w/</a>
10 min	<p>Detyra tjetër për grupet është të diskutojnëmbi temat që kanë identifikuar dhe të formulojnë një dilemë mbi të cilën do të punojnë. <b>Duhet të bëhet</b></p>	
15 min	<p>Mësuesi/ja fton çdo grup në 3 deri në 5 minuta për të paraqitur dilemën përfundimtare që planifikojnë të trajtojnë.</p>	
2 min	<p><b>Momenti i mbylljes</b></p>	

## **Burime shtesë për trajnerët/et**

1. Teknikat e Brainstorming
  - a. [Harta e mendjes për mësuesit: Këshilla, mjete dhe plane mësimore](#)
  - b. [Kutia e mjeteve të të menduarit kritik: Si të përdorim Brainstorming | Edutopia](#)
  - c. [Si mund ta lehtësojmë Brainstorming në klasë?](#)

**Shtojca I: [Manuali i trajnerëve/eve](#)**

**Shtojca II: [Fletore pune për pjesëmarrësit/et](#)**